



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2024

**VENDIM**

**Nr. 227, datë 25.04.2024**

**PËR**

**FILLIMIN E PROCEDURËS SË PËRSHPEJTUAR TË DETYRUAR TË  
VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL, VITI KALENDARIK 2023, PËR  
GJYQTAREN {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronjat “a” dhe “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 85 e vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 61, pika 1, 63 dhe 86, shkronja “dh” të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263 datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe vendimin nr.127, datë 11.03.2024 “Për miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, një vlerësim, si dhe të gjyqtarëve që nuk kanë e nuk mund të kenë asnjë vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 73, nr.74, nr.75, nr.76, nr.77, nr.78, nr.79, nr.80, nr.81, nr.82, nr.83, nr.84 dhe nr.86, datë 20.02.2024”, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale dhe mbas shortit të realizuar,

**VENDOSI:**

1. Fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2023, për gjyqtaren {...}.
2. Caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për gjyqtaren znj. {...}  
- Relator znj.Irena Plaku- Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Erlanda Agaj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**